REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTICIJE - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit 02 — Nr.i Prot / Broj Prot / Prot.No. 746
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No. Pages 02 — Data / Datum / Date: 06-06-2018
Prishtinë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**
**Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulaganja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments**
**Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm-Kancelaria Generalni Sekretara- Office of the Secretary**

Nr. 746
Dt. 6.6.2018

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), në pajtim me nenin 17 (paragrafët 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) dhe Rregulloren nr. 07/2011, Rregulloren nr. 14/2017, Rregulloren nr. 15/2017 dhe Rregulloren nr. 16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011, neni 16, paragrafi 3, të Rregullores nr. 04/2-17 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në bazë të vendimit me nr. prot.670, i dt.17.05.2018, lidhur me formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektpropozimeve për mbështetje financiare të OJQ-ve, komisioni vlerësues nxjerr këtë:

## VENDIM

**1.**Komisioni vlerësues, i themeluar sipas vendimit nr.670, i dt.17.5.2018, duke u bazuar në thirrjen publike të dt. 3.4.2018 për mbështetje financiare të OJQ-ve, sipas kritereve vlerësuese, ka përcaktuar aplikantët e kualifikuar, të cilët përfitojnë mbështetje financiare.

**2.**Pjesë përbërëse e këtij vendimi, është lista e projekteve të përzgjedhura për mbështetje financiare të OJQ-ve, që fillon nga numri rendorë 1(një) dhe përfundon me numrin rendor 29( njëzet e nëntë), me numër të protokollit 745, të datës 06.06.2018.

**3.**Shpallja e rezultateve për aplikantët e kualifikuar , sipas pikës 1 të këtij vendimi, është bërë sipas renditjes së pikëve të vlerësimit, të bazuara në kriteret ligjore të thirrjes publike, nga komisioni vlerësues i MDIS-it.

**4.**Vendimi hyn në fuqi, nëse brenda afatit të paraparë sipas Rregullores nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nëse nuk paraqitet ndonjë ankesë ose pas trajtimit të ankesave të aplikantëve nga komisioni për ankesa.

## Arsyetim

Bazuar në Rregulloren nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe të vendimit nr.670, i dt.17.5.2018 për themelimin e komisionit vlerësues për vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga OJQ-të, në fazën preliminare, nga 123 aplikacione, kriteret e vlerësimit procedural-administrativ i kanë plotësuar 45 (katërdhjetë e pesë) OJQ.

Gjatë procesit të fazës së dytë të vlerësimit- vlerësimet nga aspekti përmbajtjesor, komisioni vlerësues, bazuar në kriteret e thirrjes publike për mbështetje financiare të OJQ-ve, ka vlerësuar se 29 (njëzetenëntë) aplikacione të OJQ-ve, të renditura sipas nenit 2 të këtij vendimi, i kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike, prandaj janë kualifikuar për mbështetje financiare nga MDIS-i.

Komisioni vlerësues ka vlerësuar se 94 (nëntëdhjetë e katër) aplikacione nuk i kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike dhe, si rrjedhojë, nuk i kanë marrë pikët e mjaftueshme për t'u kualifikuar për mbështetje financiare.

**Udhëzime juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në afatin prej 5 ditësh, nëpërmjet arkivit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.**

Anëtarët e komisionit të vlerësimit të projektpropozimeve:

1. Elis Badalli, kryesues ; ____________;
2. Besim Berisha, anëtar ; ____________;
3. Mizbah Mustafa, anëtar; ____________;
4. Fadil Ademi, anëtar-përfaqësues i OJQ-ve; ____________;
5. Arbnor Çitaku, anëtar- ekspert i jashtëm; ____________;

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA * REPUBLIC OF KOSOVO
PRISHTINË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTICIJE - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 02
Nr.i Prot / Broj Prot / Prot.No.: 745
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No. Pages: 01
Data: / Datum / Date: 06.06.2018
Prishtinë a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulaganja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments

# Lista e OJQ-ve që kalojnë vlerësimin për subvencione 2018

| Nr. | Emri i OJQ-së | Titulli i Projektit | Pikët | Shuma e subvencionuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Alb Info | Revista AlbInfo | 70 | 2,300.00 |
| 2 | Lidhja e Krijueseve Shqiptarë në Mërgatë | Akademi për Gjergj Kastriotin dhe 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës | 76 | 2,200.00 |
| 3 | Hardh Fest | HardhFest për diasporën | 68 | 2,050.00 |
| 4 | BKSHKK | Bashkëpunimi ndërkulturor kroato - shqiptarë | 70 | 2,125.00 |
| 5 | Codex | Nxitja e diasporës dhe mërgates për investime të përbashketa dhe kanalizimi i remitencave në Kosovë | 72 | 2,020.00 |
| 6 | Autostrada Biennale | Autostrada artistike për zhvillimin socio-ekonomik | 67 | 2,125.00 |
| 7 | New ideal for life - NIL | Ne për mërgimtarët, mërgimtarët për ne | 63 | 2,000.00 |
| 8 | Këshilli rinor - Rahoveci | Diaspora e vendit tim | 83 | 2,000.00 |
| 9 | Progress Center | Promovimi i potencialit për investime që ofron Kosova | 65 | 2,100.00 |
| 10 | Agro Medicine | Artana vend atraktiv për investime nga diaspora | 81 | 2,150.00 |
| 11 | Liga shqiptare e futbollit në Austri | Organizimi i garave të kupës | 71 | 2,200.00 |
| 12 | FC Kosova Munchen | Ditët e kulturës shqiptare në Bavari | 70 | 2,100.00 |
| 13 | Skenderajlive | Diaspora 2018 - Skenderaj | 81 | 2,070.00 |
| 14 | Këshilli kombëtar i shoqatave shqiptare në Austri | Ansambli Shota, 10 vjet marrëdhenie diploamtike Kosovë - Austri | 75 | 2,140.00 |
| 15 | Shoqata e mësuesëve shqiptarë - Naim Frashëri | Kuizi i diturisë | 60 | 2,000.00 |
| 16 | Shqiponjat e Dardanës | Organizimi i vizitës me bashkatdhetarë në parkun arkeologjik "Ulpiana" për t'u njohur me pasuritë e Kosovës | 67 | 2,050.00 |
| 17 | Federata e futbollit shqiptare në Gjermani | Gara për kupën e Kosovës në futboll - Gjermani | 83 | 2,300.00 |
| 18 | Shoqata kultutore Iliria - Slloveni | Gjaku i Skenderbeut në Koper | 58 | 2,000.00 |
| 19 | Instituti LEDS | DilniFest 2018 | 70 | 2,080.00 |
| 20 | Qendra për politika hulumtuese | Diaspora dhe investimet në Kosovë | 74 | 2,150.00 |
| 21 | VKBIK | Dani dijasporu mladih bosnjaka Prizrena 2018 | 70 | 2,060.00 |
| 22 | Arma | Hiking për të ruajtur identitetin dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporë | 67 | 2,100.00 |
| 23 | Youth Dreams | Promovimi i vlerave historike dhe kulturore të trojeve tona | 70 | 2,080.00 |
| 24 | Kosova UNI | Kosova më afër | 69 | 2,150.00 |
| 25 | Dita | Mire se vini diasporë | 86 | 2,100.00 |
| 26 | Rinas | Shqiptarë kudo që jemi | 67 | 2,150.00 |
| 27 | Trupa teatrale profesioniste - Pejë | Jet o Jetë | 76 | 2,000.00 |
| 28 | ProKult | Festivali kombëtar i letërsisë dhe ditët e diasporës | 79 | 2,000.00 |
| 29 | Bashkësia shqiptare në prefekturën e Zarës | Arbneshi 2018 | 68 | 2,200.00 |
| | | | | 61,000.00 |

Anëtarët e komisionit të vlerësimit të projektpropozimeve:

1. Elis Badalli - Kryesues
2. Besim Berisha - Anëtar
3. Mizbah Mustafa - Anëtar
4. Fadil Ademi - Anëtar
5. Arbnor Çitaku - Anëtar

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
PRISHTINË
II